



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

R e k t o r i

Nr. 1316 prot.

Shkodër, më 07 . 04 2022

Lënda : Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Drejtuar : Agjensisë së Prokurimit Publik

pranë

Këshillit të Ministrave

Tiranë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës.

Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI
Pr./dr. Suzana Golemi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 1316/1 prot.

Shkodër, më 07.04 2022

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Mësuesisë, në pozicionin asistent-lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2021-2022 për lëndët "Metodat e kërkimit shkencor" dhe "Psikologji zhvillimore" në programet e studimit "Master Biologji-kimi", "Master Matematikë-fizikë", "Master Informatikë& Matematikë-informatikë", "Psikologji-punë sociale" dhe "Punë sociale".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

1. Të kenë kryer ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në programin e studimit Psikologji me notë mesatare jo më të ulët se 9,5.
2. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë "Master i shkencave" (ose sistemin 4-vjeçar) ose DIND (diplomë e integruar e nivelit të dytë) me drejtim "Psikologji klinike dhe komuniteti" me notë mesatare jo më të ulët se 9,5.
3. Të kenë dhënë domosdoshmërisht provim lëndët për të cilat pretendojnë të jenë mësimdhënës dhe të kenë noten mesatare të lëndëve për të cilat konkurrojnë jo më të ulët se 9,5.
4. Të kenë mbrojtur një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së me notë jo më të ulët se 8 ose të njohur nga kuadri i Përbashkët i Referencave për gjuhët me nivelin C1.
5. Preferohet :
 - 5/1. të kenë publikime që vërtetojnë aftësi në kërkimin shkencor dhe potencial për aktivitet të suksesshëm në universitet,
 - 5/2. të kenë përvojë pune mbi pesë vjet në mësimdhënie në profilin "Psikologji".

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë aftësi të punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
6. Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo **krushqie** (prind, fëmijë,

vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës egzistues brenda të njëjtes njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë “on-line” në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore “Doktor” në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose titujve akademikë (nëse ka të tilla).
5. Dy rekomandime nga të cilat të paktën një prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbarimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë + certifikatë vaksinimi anti-Covid)
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të rregullores së posaçme të Universitetit “Për zënien dhe ruajtjen e vendit të punës” (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

Shënim :

- *Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.*
- *Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik.*
- *Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.*
- *Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.*
- *Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t’i drejtoheni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.*

REKTORI
Prof.dr. Suzana GOLEMI